



---

**MEMORANDUM BASHKËPUNIMI**

**NDËRMJET**

**AGJENCISË KOMBËTARE ITALIANE  
PËR VLERËSIMIN E UNIVERSITETEVE DHE INSTITUTEVE KËRKIMORE**

**DHE**

**AGJENCISË SË SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË**

**Tiranë/Romë**

**Nëntor 2022**

---

**Agjencia Kombëtare Italiane për Vlerësimin e Universiteteve dhe Instituteve Kërkimore (më tej ANVUR), të cilën e përfaqëson presidenti i saj, Z. Antonio Felice Uricchio**

**Dhe**

**Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë e Republikës së Shqipërisë (më tej ASCAL), të cilën e përfaqëson titullari i saj, Znj. Xhiliola Bixheku, që këtu e më poshtë do t'i referohemi si "Palët",**

*Duke qenë se ANVUR, agjenci me te drejta të plota dhe ASCAL agjenci e asociuar pjesë e ENQA-s që operojnë në Zonën Evropiane të Arsimit të Lartë (EHEA);*

*Duke marrë parasysh nevojën e bashkëpunimit ndërinstitucional mes dy vendeve tona;*

*Me qëllim për të thelluar marrëdhëniet tona në fushën e sigurimit të cilësisë në arsimin e lartë dhe rritur besimin duke promovuar bashkëpunime frytëdhënëse;*

*Për t'u siguruar që bashkëpunimi do të kontribuojë në rritjen e cilësisë së arsimit të lartë dhe respektimin e Standardeve dhe Udhëzimeve për Sigurimin e Cilësisë në Hapësirën Evropiane të Arsimit të Lartë (ESG);*

*Me qëllim nxitjen për zbatimin e standardeve dhe procedurave evropiane (ESG) në sistemet e arsimit të lartë;*

*Me synimin për bashkëpunim në plotësimin e kriterëve dhe rekomandimeve të Asociacionit Evropian të Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë (ENQA) dhe Regjistrin Evropian për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin e Lartë (EQAR);*

*Palët kanë rënë dakord të lidhin këtë Memorandum Bashkëpunimi:*

## Neni 1

### Qëllimi

1. ANVUR dhe ASCAL bien dakord për bashkëpunim të ndërsjellë në sigurimin e cilësisë në arsimin e lartë, ruajtjen e standardeve të cilësisë dhe promovimin dhe përmirësimin e cilësisë së Institucioneve të Arsimit të Lartë e të programeve që ato ofrojnë.
2. ANVUR dhe ASCAL synojnë të ofrojnë bashkëpunim të ndërsjellë në plotësimin e kritereve dhe rekomandimeve të Asociacionit Evropian të Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë (ENQA) dhe Regjistrin Evropian për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin e Lartë (EQAR).

## Neni 2

### Objekti i bashkëpunimit

ANVUR dhe ASCAL angazhohen që të bashkëpunojnë në:

1. Shkëmbimin e përvojave të mira ndërmjet dy shteteve në fushën e sigurimit të cilësisë në arsimin e lartë, rritjen e cilësisë dhe kulturën e cilësisë;
2. Shkëmbimin e informacionit rreth cilësisë, rezultateve dhe akreditimit të Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe programet që ato ofrojnë;
3. Të promovojnë shkëmbimin e ekspertëve dhe vlerësuesve në pjesëmarrjen e tyre reciproke në procedurat e vlerësimit të jashtëm, duke u përqëndruar kryesisht në fushat me interes dhe kompetencë të veçantë të këtyre agjencive;
4. Aplikimin e përbashkët në projekte dypalëshe/shumëpalëshe ndërkombëtare në fushën e sigurimit të cilësisë në arsimin e lartë;
5. Shkëmbimin e njohurive rreth rregulloreve, udhëzimeve, manualeve apo çdo akti tjetër ligjor që rregullon fushën e sigurimit cilësisë në arsimin e lartë;
6. Kontributin për ndërkombëtarizimin e institucioneve të tyre kombëtare të arsimit të lartë;
7. Shkëmbimin e stafit për shkëmbimin e eksperiencave midis tyre.

## Neni 3

### Koordinimi mes palëve

ANVUR dhe ASCAL do të koordinojnë zbatimin e këtij bashkëpunimi duke:

1. Caktuar pika kontakti për bashkëpunim ndërmjet institucioneve respektive;
2. Personat e kontaktit nga të dyja palët do të jenë të disponueshëm në çdo kohë për komunikimin dhe koordinimin me qëllim rakordimin e veprimeve që duhet të ndërmerren rast pas rasti;
3. Ngritjen e grupeve të punës për fusha të caktuara bashkëpunimi;
4. Organizimin e seminareve, trajnimeve dhe takimeve të rregullta në baza vjetore për çështje specifike që lidhen me misionin e tyre (si diversiteti, përfshirja, qëndrueshmëria ose ndikimi).

## Neni 4

### Të drejtat dhe detyrimet

ANVUR dhe ASCAL zotohen që:

1. Do t'i ofrojnë njëra tjetrës informacione të besueshme lidhur me proceset e vlerësimit të jashtëm në Institucionet e Arsimit të Lartë dhe programeve që ato ofrojnë.
2. Palët, angazhohen të mbajnë një komunikim të vazhdueshëm ndërmjet tyre dhe të shkëmbejnë çdo informacion të nevojshëm për përmbushjen e detyrave të tyre. Komunikimi do të kryhet në formë shkresore ose në rrugë elektronike me anë të e-mail.
3. Informacionet e dhëna të palët garantohen që nuk do ta dëmtojnë njëra-tjetrën dhe në çdo rast të paraqitjes së një kërkesë, palët angazhohen të japin përgjigje brenda 15 ditëve.
4. Do respektohet e drejta e mbrojtjes së të dhënave personale sipas ligjeve respektive kombëtare të secilës palë.
5. Të komunikojnë dhe konsultohen rreth çështjeve me interes të përbashkët, në mënyrë që të koordinojnë aktivitetet e Agjencive përkatëse dhe të mos kundërshtojnë njëra-tjetrën.
6. Deri në përfundimin e këtij Memorandumi, palët do t'u përmbahen termave dhe kushteve që rrjedhin nga ky Memorandum, për sa i përket informacionit dhe dokumenteve të shkëmbyera përpara datës së përfundimit të tij.

## Neni 5

### Konfidencialiteti

Palët marrin përsipër të mbajnë konfidenciale çdo informacion, dokument ose material tjetër që do të shkëmbejnë mes tyre dhe të zbatojnë parashikimet ligjore të secilit vend për përdorimin e të dhënave personale.

## Neni 6

### Kohëzgjatja

1. Ky bashkëpunim është me afat kohor 5 vjeçar dhe të drejtë rinovimi në heshtje në rast se palët nuk shprehen për përfundimin e saj.
2. Nëse secila palë dëshiron përfundimin e këtij bashkëpunimi, duhet të njoftohet pala tjetër së paku 3 muaj para për veprimin e ndërmarrë.

## Neni 7

### Ndryshimet

Memorandumi mund të ndryshohet vetëm me miratimin e ndërsjellët me shkrim të palëve.

## Neni 8

### Zgjidhja e Mosmarrëveshjeve

1. Ky Memorandum Bashkëpunimi nuk bie në kundërshtim me legjislacionin e brendshëm të të dy palëve.
2. Në rast mosmarrëveshje ose pretendimi që mund të lindë për këtë Memorandum Bashkëpunimi, palët zotohen që do të bëjnë të gjithë përpjekjet e mundshme që ti zgjidhin ato përmes konsultimeve dhe negociatave.

## Neni 9


### Dispozita të fundit

1. Ky Memorandum Bashkëpunimi hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit të tij nga përfaqësuesit e palëve.
2. Secila palë merr përsipër njohjen e strukturave të institucionit me detyrimet e këtij Memorandumi, si dhe respektimin e zbatimin e detyrimeve që rrjedhin prej tij.
3. Për çdo rast të mosplotësimit të detyrimeve të mësipërme secila palë të informojë titullarin e institucionit.
4. Çdo aneks për të cilin palët do të bien dakord dhe do të nënshkruajnë në të ardhmen, i cili do të dalë në bazë dhe për zbatim të këtij Memorandumi, do të konsiderohet si pjesë përbërëse dhe e pandarë e tij.
5. Aktivitetet që rrjedhin nga kjo marrëveshje bashkëpunimi nuk përfshijnë asnjë angazhim financiar nga palët.
6. Ky Memorandum Bashkëpunimi nënshkruhet në 2 (dy) kopje origjinale në gjuhën shqipe, ku një kopje do të depozitohet në Agjencinë Kombëtare Italiane për Vlerësimin e Universiteteve dhe Instituteve Kërkimore dhe një kopje në Agjencinë e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë të Republikës së Shqipërisë.

Ky Memorandum Bashkëpunimi u nënshkrua sot, në datë 10 / 11 /2022.

**PËR AGJENCINË KOMBËTARE  
ITALIANE PËR VLERËSIMIN E  
UNIVERSITETEVE DHE  
INSTITUTEVE KËRKIMORE**

Prof. Antonio Felice Uricchio



**PËR AGJENCINË E SIGURIMIT TË  
CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË**

Dr. Xhiliola Bixheku

